

HIDRO IZOLUESIT



HIDROFIX II

	Ngjyra	Paketimi	Konsumi
A	Gri	Thes 25 KG/12 KG	1.65 (kg/m ²)/mm trashësia
B	E bardhë	Lëng 8 KG/4 KG	

PËRSHKRIM

Material hidroizolues dykomponent me fleksibilitet të lartë me bazë çimento, inertesh të seleksionuar me rërë të imët me aditiv specifik dhe polimer fleksibël. Ka punueshmëri të mirë dhe falë rezinave organike përbërëse ka aftësi shumë të mira në ngjitje mbi të gjitha tipet e bazamenteve (gjithmonë të qëndrueshme dhe të pastra) në betone dhe mure, duke krijuar një shtresë fleksibël dhe të pa përshkueshme. Për ambiente të jashtme dhe të brëndshme.

FUSHA E APLIKIMIT

Veti shumë të mira në ngjitje mbi të gjitha tipet e bazamenteve. Mbrojtje fleksibël dhe hidroizoluese për banjo, dushe, ballkone, bodrume, tarraca dhe pishina. Hidroizolues përpara vendosjes së pllakave qeramike, për suva, dysheme, sipërfaqe betoni, i përshtatshëm për riparime mbi parafabrikate. Mbrojtës i sipërfaqeve të betonit në efektin e lagështisë së vazhdueshme, klorureve, sulfateve, etj.

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Hidhni komponentin B të lëngshëm (8KG) në një enë të pastër dhe duke e përzier hidhni komponentin A të thatë (25KG). Përzieri me një përzierës mekanik derisa të arrihet një masë homogjene, pa kokrriza dhe pa fluska ajri. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vajra, jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Përafërsisht dyshemetë tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhionimi të paktën 28 ditë, bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhet të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike. Të vendoset në të gjitha këndet midis murit dhe dyshemesë, nyjeve teknike dhe atyre të kullimit shiriti hidroizolues prej 10 cm.

APLIKIMI

Aplikoni produktin në dy shtresa me furçë, rul ose shpatull, duke e aplikuar rreth 2mm për çdo dorë duke vendosur në dorën e parë një rrjetë me fibra qelqi mbi produktin e njomë. Dora e dytë aplikohet pas një periudhe prej 4-6 orë nga njëra-tjetra dhe jo para tharjes së dorës së parë. Produkti përdoret vetëm duke kombinuar komponentin A me komponentin B dhe në sasinë e rekomanduar. Aplikoni produktin në temperatura nga +5°C deri +35°C.



TË DHËNAT TEKNIKE

Komponenti A	
Pamja: Pluhur	Trashësia për shtresë: 1-2 mm (për dorë)
Paketimi: Thes letre 25 kg ne paleta 1350 kg	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Ngjyra: Gri	Kokrrizimi: 0.7mm
Konsumi: 1.65 kg/mm trashësi	Ngjitja në beton (28 ditë): ≥0.6 N/mm ²
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	Përkueshmëria ndaj ujit: 0.15 kg /m ² . h0.5
Koha e Magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Forca ngjitëse pas trajtimit termik: ≥0.8 N/mm ²
pH i përzierjes: >12	Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1
Masa vëllimore: 1.6-1.7 gr/cm ³	
Komponenti B	
Pamja: Lëng	Magazinimi: 24 muaj
Paketimi: Bidon 8 Kg	Masa Vëllimore: 1.1 gr/cm ³
Ngjyra: E bardhë	

